



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUCITRN

01 NE / BF 80/21  
Nr. i fq. / BE st - 5 -  
Data: / Dati: 15.04.2021  
VUSHTRRI - VUCITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUCITRN

### PROCESVERBAL

nga mbledhja e III-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më  
11 mars 2021 në sallën e kryetarit të komunës, e cila filloj në ora 14:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Melihate Basholli-Latifi, Gresa Muli, Ymer Haradinaj, Shkëlzen Feka, Arta Ymeri, Nezir Klinaku dhe Teuta Aruçi Shartari (anëtarë të KPF -së).

Mungoi: Shpëtim Zhegrova.

*Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Drejtorët e drejtoreve (Lutfi Gërguri, Adnan Lahu, Berat Sadiku), Ismet Gashi, udhëheqës i zyrës ligjore, si dhe nga sekretaria e kuvendit Bastri Duraku dhe Bujar Klinaku.*

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Aliu theksoi se kanë ardhur dy pikë shtesë për t'u futur në rend të ditës:

- Propozim – vendim për bartjen e të hyrave vetanake dhe
- Shpërndarja e mjeteve financiare nga subvencionet dhe transferet për vitin 2021.

**Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – sqaroi se sa i përket bartjes së të hyrave, thesari duhet të na jep një raport përfundimtar për bartjen e të hyrave, ku ende nuk na është dhënë. Mirëpo, në bazë të sistemit të ribalancit i kemi nxjerrë këto shuma financiare, të cilat mund të lëvizin më së shumti për 10 – 20 euro, jo më shumë.

Ndërkaq, për shpërndarje të subvencioneve, ne e patëm bërë një kërkesë, ku në janar ishte marrë vendimi për tejkalimin e të hyrave vetanake në vlerë prej 190 mijë euro dhe se ky vendim ende nuk është ekzekutuar nga ministria. Si të kryhet kjo, ne e bëjmë shpërndarjen nëpër drejtori dhe e sjellim në kuvend, tha ai.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – tha se kryetari i komunës nuk e ka nënshkruar, prandaj a është ky propozim me pëlgim të kryetarit apo jo, ose le ta nënshkruajë nënkyryetari.

**Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – theksoi se për kuvend do të nënshkruhet ky propozim.

*Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:*

## R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 11 shkurt 2021;
  2. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko- financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2020;
  3. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për rrënimin e objektit të ish Gjykatës së Komunës;
  4. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Sheshit të Pavarësisë në Vushtrri;
  5. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2020/2021;
  6. Shqyrtimi i Draft – statutit të Qendrës për Punë Sociale;
  7. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Ndërmarrjes regionale “Uniteti”;
  8. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2020 në vitin 2021;
  9. Shpërndarja e mjeteve financiare nga subvencionet dhe transferet për vitin 2021;
  10. Të ndryshme.
- 
1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 11 shkurt 2021.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – ai tha që është mirë të na vijnë dokumentet e nënshkruara.

**Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF- së** – theksoi se procesverbalet zakonisht i nënshkruajmë pasi që të miratohen në mbledhje.

**Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 11 shkurt 2021.**

2. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko- financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2020.

**Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF- së** – tha se janë disa gabime drejtshkrimore, prandaj është mirë të përmirësohen për kuvend.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – ky raport ka edhe gabime teknike, por edhe drejtshkrimore. Të përmirësohet për kuvend.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.**

3. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për rrënimin e objektit të ish Gjykatës së Komunës.

**Gresa Muli, anëtare e KPF-së** – deklaroi se është hera e tretë që po na vjen ky propozim. Ne si grup i VV-së kemi kërkuar që të zhvillohen procedurat sipas vendimit paraprak dhe kur të dështojnë ato (siç aludon kryetari) ne vazhdojmë me vendimet tjera, e jo të na sjellet pa u zhvilluar procedurat për vendimin paraprak. Unë nuk e përkrahu asnjëren nga pikat 3 dhe 4.

**Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit** – tha se edhe në seancën e muajit të kaluar e kemi pasur si pikë, por nuk ka kaluar në KPF, ku është kërkuar se nëse nuk është urgjente mos të procedohet. Po ashtu, është kërkuar që në propozim të futet një pikë që shfuqizon vendimin paraprak. Ai tha se qe dy vite nuk ka pasur të interesuar për këtë objekt të ish – gjykatës, por as për pronat tjera që janë marrë me të njëjtin vendim. Prandaj, këtë propozim e kemi të kompletuar.

**Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së** – pyeti se pas rrënimit të objektit, sa është sipërfaqja që do të lirohet për ta bërë një shesh? A ka rregull të caktuar se sa duhet të ketë sipërfaqe për një shesh?

**Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit** – deklaroi se parcela në fjalë ka  $473\text{ m}^2$  ose 4 ari e  $73\text{ m}^2$ . Kemi rastin që edhe me 3 ari është bërë shesh. Ai tha se nuk ka ndonjë rregull të caktuar se sa duhet hapësirë publike për shesh.

**Gresa Muli, anëtare e KPF-së** – si duket LDK-ja po bie në kundërshtim me fjalët e veta. Në njëren anë po thirret në hapësira publike, në anën tjetër blokon hapësira publike, madje edhe oborre të shkollës, siç ka ndodhur me shkollën në Nedakoc, ku oborri i saj ka mundur të bëhet park, por është ndërtuar një depo, goxha në mënyrë ilegale. Edhe ne jemi për hapësira publike, por jo në këtë mënyrë.

**Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit** – tha se nuk ka kurrfarë pengese ligjore investimi i depos në Nedakoc.

**Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së** – tendenca e qeverisë komunale për ta rrënuar këtë objekt ka një prapavijë, sepse po fshihet diçka. Nuk po i kuptoj se si ka mundësi që të mos të ketë të interesuar për një objekt në qendër të qytetit, kurse nëpër fshatra kryetari objektet e shkollës po i shndërron në fabrika të rrobaqepësisë. Nuk do ta përkrahu një propozim të tillë, pasi që prapa tij fshihet diçka.

**Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë** – kërkoi nga Lëvizja Vetëvendosje që të jenë më konkret.

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me pesë (5) vota “për” dhe dy (2) “kundër” dhe një (1) “abstenim” rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

4. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Sheshit të Pavarësisë në Vushtrri.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me pesë (5) vota “për” dhe tri (3) “kundër” rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

5. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2020/2021.

**Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së** – Nuk po dua të flas lidhur me përbajtjen e informatës , pasi që askush nga drejtoria nuk është i pranishëm.

Në shkollat tona nuk ka gjysmëvjetor të parë e as të dytë, por ka periudhë të parë, dytë dhe tretë. Prandaj, kjo është informatë për përfundimin e periudhës së parë.

**Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së** – tha se shqetësim është furnizimi me vonesë me lëndë djegëse, ku shumica e shkollave në periudhën e parë nuk kanë pasur lëndë djegëse. Kërkojmë nga Drejtoria për Arsim që t'i respektojë afatet ligjore dhe furnizimi me lëndë djegëse të bëhet me kohë.

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

6. Shqyrtimi i Draft – statutit të Qendrës për Punë Sociale.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me shtatë (7) vota “për” dhe një (1) “abstenum” rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

7. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Ndërmarrjes regionale “Uniteti”.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – theksoi se do të ishte mirë që përfaqësuesi i kompanisë “Uniteti” të jetë i pranishëm në mbledhjen e kuvendit.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

8. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2020 në vitin 2021.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

9. Shpërndarja e mjeteve financiare nga subvencionet dhe transferet për vitin 2021.

**Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – sqaroi se sikur viteve të kaluara që është bërë kategorizimi, edhe këtë vit do të vjen njëjtë kategorizimi. Sapo të na vjen reporti nga thesari ne do ta procedojmë propozim – vendimin në kuvend.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

10. Të ndryshme.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – tha se sa ka informacione, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale është duke e bërë ndryshimin dhe plotësimin e statutit të QKMF-së, sepse kërkesë e imja ka qenë që të vjen propozimi që QKMF-së t'i vendoset emri “Dr. Safet Idrizi”.

Prandaj, duhet ta sqaroni se nëse është duke u ndryshuar dhe plotësuar statuti i QKMF-së, të futet kërkesa ime. Nëse nuk na vjen ndryshimi dhe plotësimi i statutit të QKMF-së, atëherë të na vjen propozim – vendimi për emërtimin e QKMF-së me emrin “Dr. Safet Idrizi”.

Mbledhja përfundoi në orën **14:45**.

Bujar Klinaku  
*B. Klinaku*  
Procesmbajtës

